VENDIM
Nr. 349, datë 29.4.2015

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 781, DATË 14.11.2007, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KARAKTERISTIKAT TEKNIKE E FUNKSIONALE TË PAJISJEVE FISKALE, SISTEMIT TË INTEGRUAR TË KOMPJUTERIZUAR PËR TRANSFERIMET PERIODIKE, AUTOMATIKE, TË DEKLARIMEVE FINANCIARE, SISTEMIT TË KOMUNIKIMIT, PËR PROCEDURËN E DOKUMENTACIONIN PËR MIRATIMIN E TYRE DHE PËR KRITERET PËR PAJISJEN ME AUTORIZIM TË SHOQËRIVE TË AUTORIZUARA PËR OFRIMIN E PAJISJEVE FISKALE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 55, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 6.1, "Sistemi fiskal për shoqëritë e hidrokarbureve me pakicë", të vendimit nr. 781, datë 14.11.2007, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja "a", e pikës 2, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"a) Në rast defekti të pajisjes fiskale apo lidhjes me të, KDE-ja duhet të sigurojë mosfunksionimin e dispeçerit, deri në çastin e rregullimit të këtij defekti.".

2. Fjalia e katërt, e shkronjës "c", ndryshohet, si më poshtë vijon:

"... Furnizimi me karburant kryhet vetëm pas autorizimit nga pajisja fiskale dhe KDE-ja nën regjimin automatik, sipas parimit "Pa kupon, s'ka karburant.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama